

ALBSIG JETE sha

**Pasqyrat financiare individuale
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024**

me raportin e Audituesit të pavarur

PËRMBAJTJA

	Faqe
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	i-iii
PASQYRA INDIVIDUALE E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA INDIVIDUALE E FITIMIT OSE HUMBJES DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA INDIVIDUALE E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA INDIVIDUALE E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	4
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINANCIARE INDIVIDUALE	5-34
SKEDULET PLOTËSUESE	I-IV

RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR

Për Aksionarin e Shoqërisë Albsig Jetë sh.a.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë Albsig Jetë sh.a. ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën individuale të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2024, si dhe pasqyrën individuale të fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, si dhe pasqyrën individuale të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën individuale të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare individuale, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël materiale.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare individuale bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2024, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me bazat e përgatitjes siç tregohet në shënimin 2.1 të pasqyrave financiare individuale.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës të Kontabilistëve Profesionistë (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEKP) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEKP.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje tjetër

Pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 janë audituar nga një auditues tjetër i cili ka shprehur një opinion pa rezervë mbi ato pasqyra financiare të individuale në 4 qershor 2024.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
ASSURANCE | TAX | CONSULTING

RSM Albania SH.P.K is part of the RSM network and trades as RSM. RSM is the trading name used by the members of the RSM network. Each member of the RSM network is an independent accounting and consulting firm, which practices in its own right. The RSM network is not itself a separate legal entity in any jurisdiction.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare Individuale

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me bazat e përgatitjes siç tregohet në shënimin 2.1 të pasqyrave financiare individuale, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare individuale që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare individuale, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare individuale në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare individuale.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare individuale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.



- Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare individuale ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare individuale, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare individuale paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.


Raporte të tjera mbi Kërkesat e Kuadrit Rregullator

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për përgatitjen e skeduleve shoqëruese plotësuese të Aftësisë Paguese dhe Aktiveve për Mbulimin e Detyrimeve të Sigurimit ("skedule plotësuese") në përputhje me ligjin "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit". Bazuar në kërkesat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri, ne kemi lexuar skedulet plotësuese shoqëruese. Këto skedule plotësuese të përgatitura nga Drejtimi nuk janë pjesë e këtyre pasqyrave financiare individuale. Informacioni historik financiar, i paraqitur në skedulet shtesë të këtyre pasqyrave financiare individuale, është në përputhje me informacionin vjetor financiar shpalosur në pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë më 31 dhjetor 2024, përgatitur në përputhje me kërkesat e raportimit financiar për Shoqëritë e Sigurimit në Shqipëri.

Bujar Bendo
Auditues Ligjor
RSM Albania



Tiranë, 28 prill 2025



ALBSIG JETE SHA

Pasqyra individuale e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2024
(Shumat ne Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Aktivët			
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	6	46,763,846	31,935,735
Depozita me afat me bankat	7	554,286,459	530,122,315
Llogari të arkëtueshme sigurimi, neto	8	82,498,895	50,362,518
Aktive të risigurimit	9	78,279,148	41,845,020
Të tjera llogari të arkëtueshme	10	1,120,867	2,170,244
Investime në tituj borxhi	11	34,630,000	35,776,000
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	12	0	12,777
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	13	58,677,467	41,109,353
Aksione në shoqëri të lidhura	14	69,000,000	69,000,000
Aktive afatgjata materiale	15	95,333,802	19,547,502
Aktive afatgjata jomateriale	16	1,237,958	500,526
Totali i aktiveve		1,021,828,442	822,381,990
Detyrimet			
Rezervat për primet e pafituar	17	164,885,780	121,534,750
Rezerva teknike për demet	18	85,277,825	42,588,392
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	19	450,000	3,297,239
Detyrim tatim fitimi	29	2,126,362	3,303,773
Detyrime te tjera	20	56,168,052	35,329,041
Totali i detyrimeve		308,908,019	206,053,195
Kapitali			
Kapitali aksionar	21	432,254,000	432,254,000
Fitime të mbartura		184,074,795	105,191,371
Fitimi i ushtrimit		96,591,628	78,883,424
Totali i kapitalit		712,920,424	616,328,795
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		1,021,828,442	822,391,990

Shënimet shpjeguese ne faqet 5-34 janë pjese e pandare e këtyre pasqyrave financiare individuale.

ALBSIG JETE SHA

Pasqyra individuale e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera gjithëpërfshirëse për periudhën që mbyllet me 31 dhjetor 2024 (Shumat ne Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Prime të shkruara bruto	22	500,130,722	333,006,615
Prime të çeduara në risigurim	23	(55,921,730)	(45,059,847)
Prime të shkruara neto		444,208,992	287,946,768
Ndryshimi në rezervën e primeve të pafituara	17	(43,351,030)	(3,269,521)
Ndryshimi në rezervën e primit të risiguruesit	9	8,643,580	11,571,711
Të ardhura neto nga primet e sigurimit		409,501,542	296,248,958
Të ardhura nga interesi	24	17,059,899	10,104,916
Të ardhura të tjera		15,849,050	11,058,796
Të ardhura te tjera		32,908,949	21,163,712
Të ardhurat neto		442,410,491	317,412,670
Dëme të paguara te sigurimit	25	(36,542,555)	(17,335,929)
Ndryshimi në rezervën e dëmeve	18	(42,689,433)	(29,232,061)
Ndryshimi në rezervën e dëmeve të risiguruesit	9	27,790,548	5,821,311
Dëme të sigurimit neto		(51,441,440)	(40,746,679)
Kostot e marrjes në sigurim	26	(196,809,990)	(116,832,242)
Ndryshimi në shpenzime të shtyra	13	17,568,114	(2,054,397)
Shpenzimet administrative	27	(78,797,605)	(53,351,513)
Te ardhura financiare neto	28	(19,147,607)	(11,476,328)
Total shpenzime operative		(277,187,088)	(183,714,480)
Fitimi i vitit para tatimit		113,781,963	92,951,511
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin			
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	29	(17,190,335)	(14,068,087)
Fitimi i vitit pas tatimit		96,591,628	78,883,424
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		96,591,628	78,883,424


Shënimet shpjeguese ne faqet 5-34 janë pjese e pandare e këtyre pasqyrave financiare individuale.

ALBSIG JETE SHA

Pasqyra individuale e ndryshimeve ne kapital me 31 dhjetor 2024
(Shumat ne Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Fitimi i mbartur	Fitim i vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2022	432,254,000	35,070,951	70,120,420	537,445,371
Pagesa e kapitalit të papaguar	-	-	-	-
Fitimi i vitit	-	-	78,883,424	78,883,424
Transferim në fitime të mbartura	-	70,120,420	(70,120,420)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2023	432,254,000	105,191,371	78,883,424	616,328,795
Emetim kapitali aksionar	-	-	-	-
Fitimi i vitit	-	-	96,591,628	96,591,628
Transferim në fitime të mbartura	-	78,883,424	(78,883,424)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2024	432,254,000	184,074,795	96,591,628	712,920,423

Shënimet shpjeguese ne faqet 5-34 janë pjese e pandare e këtyre pasqyrave financiare individuale. Pasqyrat financiare u aprovuan nga drejtimi i Shoqërisë Albsig Jetë sha, me 7 prill 2025 dhe u firmosen nga:


Z. Ervin Spahiu
Drejtore i Përgjithshëm




Z. Irfan Lami
Drejtore i Financës

ALBSIG JETE SHA

Pasqyra individuale e flukseve të parasë për periudhën që mbyllet më 31 dhjetor 2024
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Flukset monetare nga aktivitetet operative			
Fitimi neto para tatimit		113,781,964	92,951,511
<i>Rregullime për zërat jo-monetare në fitim ose humbje:</i>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	15,16	1,477,788	1,040,283
Të ardhurat nga interesi	24	(17,059,899)	(10,104,916)
Shpenzim tatimi mbi fitimin	29	(17,190,335)	(14,068,087)
Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin qarkullues		81,009,518	69,818,791
<i>Ndryshimet në:</i>			
Llogari të arkëtueshme sigurimi, neto	8	(32,136,376)	(8,434,488)
Aktive të risigurimit	9	(36,434,128)	(17,393,022)
Te tjera llogari të arkëtueshme	10	1,049,377	(1,633,334)
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	11	12,777	(12,777)
Inventari	12	-	-
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	13	(17,568,114)	2,054,397
Rezervat për primet e pafituar	17	43,351,030	3,269,521
Rezerva teknike për demet	18	42,689,433	29,232,061
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	19	(2,847,238)	(852,761)
Detyrim tatim fitimi	29	(1,177,411)	(3,131,745)
Detyrime të tjera	20	20,839,010	11,550,425
Fluksi monetar gjeneruar nga veprimtaria operative		98,787,878	84,467,068
<i>Flukset monetare nga aktivitetet investuese:</i>			
Blerje të aktiveve afatgjata material dhe jo materiale	15,16	(78,001,522)	(15,774,930)
Depozita me afat me bankat	7	(7,104,245)	(48,064,568)
Investime në shoqëri të lidhura	10,16	1,146,000	(20,776,000)
Fluksi monetar neto i përdorur nga veprimtaria investuese		(83,959,767)	(84,615,498)
Fluksi monetare nga veprimtaritë e financimit			
Emetimi kapitalit aksionar	21	-	-
Fluksi monetar neto i përdorur nga veprimtaritë		-	-
Ndryshimi neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë bankë		14,828,111	(148,430)
Mjetet monetare dhe ekuivalentë në fillim të vitit		31,935,735	32,084,166
Mjetet monetare dhe ekuivalentë në fund të vitit	6	46,763,846	31,935,735

Shënimet shpjeguese në faqet 5-34 janë pjesë e pandare e këtyre pasqyrave financiare individuale.

ALBSIG JETE SHA

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

1. Përshkrim i përgjithshëm

Albsig Jetë sh.a. (tani e tutje do i referohemi si “Shoqëria”) është themeluar më 2 korrik 2019 si një shoqëri sigurimi me seli në Tiranë në adresën Bulevardi “Bajram Curri”, (Downtown One) HQ 1010. Shoqëria është një shoqëri aksionare, e regjistruar sipas ligjit nr.7638, datë 19 nëntor 1992 “Për Shoqëritë Tregtare” dhe e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më 19 korrik 2019 me numër identifikimi L92019017V.

Shoqëria operon sipas licencës nr.13 të lëshuar nga Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare (tani e tutje do i referohemi si “AMF”), për të ushtruar veprimtari sigurimi jete sipas rregullave të AMF-së në territorin e Republikës së Shqipërisë. Autorizimi për të ndërmarrë aktivitetet e sigurimit të jetës është marrë më datë 13 shtator 2019. Aktivitetet kryesore të biznesit përfshijnë dhënien e shërbimeve të sigurimit për sigurim jetë-vdekje, sigurim martesë-lindje, sigurim jete i lidhur me fondet e investimit, sigurim i administrimit të fondeve kolektive, sigurim shtesë.

Kapitali i Shoqërisë është 432,254 mijë Lek i ndarë në 432,254 aksione me vlerë nominale 1.000 Leke/aksion e zotëruar 100% nga Albsig sh.a.

Më 31 dhjetor 2024, Shoqëria ka patur mesatarisht 14 punonjës dhe drejtues (31 dhjetor 2023: 12).

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë gjatë vitit 2024 deri në nënshkrimin e këtyre pasqyrave financiare janë:

- | | |
|------------------|--------|
| • Plarent Hamzaj | Anëtar |
| • Redi Ujkashi | Anëtar |
| • Klodian Gjonaj | Anëtar |

2. Bazat e përgatitjes

2.1. Deklarata e përrputhshmërisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në përrputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”), përveç implementimit të kërkesave të SNRF 17 efektive për periudhat pas 1 janarit 2025. Shoqëria aplikon SNRF 4 “Kontratat e Sigurimit” dhe jo IFRS 17 “Kontratat e Sigurimit”, në zbatim të urdhrit të ministrit të financave dhe ekonomisë nr. 106, dt. 10 maj 2023, në bazë të të cilit është shtyrë aplikimi SNRF 17 “Kontratat e Sigurimit” pas datës 1 janar 2025. Pasqyrat financiare individuale bashkëlidhur janë përgatitur në përrputhshmëri me kërkesat rregullatore. Pasqyrat financiare u aprovuan nga drejtimi i Shoqërisë Albsig sha, me 31 mars 2025, dhe u autorizuan për aprovim nga Këshilli Mbikëqyrës i saj. Pasqyrat financiare u aprovuan nga drejtimi i Shoqërisë Albsig Jete sha, me 7 prill 2024, dhe u autorizuan për aprovim nga Këshilli Mbikëqyrës i saj.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

2.3. Monedha funksionale dhe ajo e prezantimit

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek Shqiptar që është monedha funksionale dhe prezantuese e Shoqërisë dhe të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek përveç se kur është shprehur ndryshe. Monedha funksionale është monedha e ambientit primar ekonomik në të cilin Shoqëria vepron. Nëse treguesit e ambientit primar ekonomik përzihen, atëherë drejtimi përdor gjykimin e tij për të përcaktuar monedhën funksionale që paraqet në mënyrën më të vërtetë efektet ekonomike të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve në të cilat ndodhin. Investimet dhe veprimet e Shoqërisë kryhen kryesisht në Lek. Për rrjedhojë drejtimi ka përcaktuar Lekun si monedhën funksionale të Shoqërisë.

ALBSIG JETE SHA

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

2.4. Parimi i vijimësisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijimësisë dhe nuk përfshijnë ndonjë rregullim të vlerës kontabël dhe klasifikimit të aktiveve, pasiveve dhe shpenzimeve të raportuara që përndryshe mund të kërkojnë nëse baza e parimit të vijimësisë nuk do të ishte e përshtatshme.

Drejtimi i Shoqërisë beson se ka aktive të mjaftueshme dhe se ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar qëndrueshmëri dhe zhvillim të biznesit në kushtet aktuale.

2.5. Gjykimet kontabël dhe vlerësimet

Përgatitja e pasqyrave financiare, kërkon që drejtimi të bejë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në vlerën e mbartur të aktiveve dhe detyrimeve, si edhe të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura me to rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën kur këto vlerësime rishikohen dhe gjithashtu në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

3. Politika kontabël të rëndësishme

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme zbatohen për herë të parë në periudhat e raportimit financiar që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2024:

Disa standarde të cilat janë bërë efektive nga 1 janar 2024 dhe rrjedhimisht kanë hyrë në fuqi, nuk kanë ndikim të rëndësishëm në rezultatin apo pozicionin financiar të Shoqërisë.

1) Standardet e reja që mund të adoptohen më herët

- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata (Ndryshimet në SNK 1)
- Detyrimi i qirasë në një shitje dhe kthim me qira (Ndryshimet në SNRF 16)
- Marrëveshjet financiare të furnizuesit (Ndryshimet në SNK 7 dhe SNRF 7)
- Detyrimet afatgjata me marrëveshje (Ndryshimet në SNK 1)

2) Standarde dhe interpretime të reja, ende të paadoptuara

- Mungesa e shkëmbyeshmërisë (Ndryshimet në SNK 21)
- Ndryshime në Klasifikimin dhe Matjen e Instrumenteve Financiare (Ndryshime në SNRF 9 dhe 7)
- SNRF 18 "Prezantimi dhe shpalosja në pasqyrat financiare"
- SNRF 19 'Filiale pa Përgjegjësi Publike: Dhënia e informacioneve shpjeguese

Këto ndryshime nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare në periudhën e aplikimit fillestar dhe për këtë arsye shpalosjet nuk janë bërë.

ALBSIG JETE SHA

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

a) Filialet dhe konsolidimi

Filialet janë subjekte të kontrolluara nga shoqëria. Kontrolli ekziston kur shoqëria ka fuqinë, drejtpërdrejt ose indirekt, që të qeverisë politikën financiare dhe operative të një njësie ekonomike në mënyrë që të marrë përfitime nga aktivitetet e saj. Në vlerësimin e kontrollit merren parasysh të drejtat potenciale të votimit që aktualisht janë të ushtrueshme ose të konvertueshme. Në përputhje me paragrafin 4 (a) të SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, Shoqëria plotëson kriteret për përjashtimin nga përgatitja e pasqyrave financiare të konsoliduara.

Shoqëria Mëmë Albsig sha, përgatit pasqyra financiare të konsoliduara të disponueshme për përdorim publik që përputhen me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"). Pronarët nuk kundërshtojnë që Shoqëria të mos paraqesë pasqyra financiare të konsoliduara.

Investimet në filiale në këto pasqyra financiare të veçanta kontabilizohen me kosto. Më shumë detaje mbi investimet në filiale janë dhënë në Shënimin 15.

Investimet testohen për zhvlerësim sa herë që ka tregues se vlera e mbetur kontabël e tij mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse shuma e rikuperueshme e një investimi (vlera më e lartë midis vlerës së drejtë minus koston e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim) është më e vogël se vlera kontabël e saj, vlera kontabël neto reduktohet në shumën e rikuperueshme.

Vlera kontabël e një investimi çregjistrohet gjatë nxjerrjes jashtë përdorimit. Diferenca midis vlerës së drejtë të fitimit nga shitjet dhe pjesës së mbetur të vlerës kontabël neto të investimit njihet në fitim ose humbje si fitim ose humbje nga shitja. E njëjta gjë vlen edhe nëse nxjerrja jashtë përdorimit rezulton në kalimin nga filiali në sipërmarrjen e përbashkët ose në pjesëmarrje të matur me kosto.

b) Transaksione në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lek me kurset e këmbimit në datën e transaksioneve. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare të mbajtura në monedhë të huaj në datën e raportimit nuk rivekëtohen në fund viti dhe maten me koston e tyre historike (konvertuar në monedhën funksionale me kursin e asaj date) përveç, aktiveve dhe detyrimeve jo-monetare të matura me vlerën e tregut të cilat konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës kur u përcaktua vlera e tyre e tregut.

Fitimi apo humbja nga kurset e këmbimit, që rezulton nga kryerja e transaksioneve të tilla si dhe nga përkthimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare të mbajtura në monedhë të huaj, njihet në fitim ose humbje, përveç instrumenteve financiare që mbahen me VDFH, të cilat njihen si një komponent i të ardhurës neto nga instrumentet financiare në VDFH.

Kurset kryesore të konvertimit në Lek Shqiptar për 1 njësi të monedhës së huaj në datën e raportimit janë si më poshtë

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
EURO	98.15	103.88
USD	94.26	93.94

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

c) Klasifikimi i kontratave të sigurimit

Kontratat nën të cilat Shoqëria pranon të marrë një rrezik sigurimi të rëndësishëm nga një palë tjetër (policë-mbajtësi) duke rënë dakord të kompensojë policë-mbajtësin ose përfitues të tjerë për një ngjarje të caktuar të pasigurtë (ngjarja siguroese) e cila ka efekte negative dhe ndikon në policë-mbajtësin apo përfituesit e tjerë, klasifikohet si kontratë sigurimi.

Rreziku i sigurimit është i ndryshëm nga rreziku financiar. Rreziku financiar është rreziku i ndryshimeve të mundshme të ardhshme në një ose më shumë nga norma interesi specifike, çmimet e letrave me vlerë, çmimet e komoditeteve, kursi i këmbimit, indekset e çmimeve ose të normave, vlerësimi i aftësisë kredituese apo indekset e kreditimit ose variabla të tjerë, të siguruar në rastin e variablave jo-financiare kur variabli nuk është specifik për një palë në kontratë.

Pasi një kontratë është klasifikuar si një kontratë sigurimi, mbetet një kontratë sigurimi për pjesën e mbetur të jetës së saj, edhe nëse rreziku i sigurimit zvogëlohet ndjeshëm gjatë kësaj periudhe, përveç nëse të gjitha të drejtat dhe detyrimet shuhet ose skadojnë.

d) Njohja dhe matja e kontratave të sigurimit

i. Primet

Primet për sigurimin e jetës - afatshkurtra

Primet e shkruara bruto përfshijnë shumat e përfituara nga polica ose kontrata sigurimi të lidhura gjatë vitit financiar në lidhje me sigurimin e drejtpërdrejtë, pavarësisht nga fakti se shumat të tilla mund të lidhen tërësisht apo pjesërisht me një periudhë të mëvonshme në kontabilitet. Primet paraqiten bruto përfshirë komisionet e ndërmjetësve dhe taksat e bazuara në prime. Pjesa e fituar e primeve të pranuar njihet si e ardhur. Primet janë të fituara nga data e marrjes përsipër të rrezikut, përgjatë periudhës së sigurimit, bazuar në modelin e rrezikut të nënshkruar.

Primet për sigurimin e jetës - afatgjata

Për kontratat e sigurimit që kontraktohen me debitorë të Bankave të nivelit të dytë në Shqipëri, dhe që kanë afat disa vjeçar, për mbulimin e kredisë gjatë afatit të shlyerjes së saj, Shoqëria njihet në të ardhura primin e shkruar bruto vjetor në momentin që lëshon kontratën e sigurimit.

Për kontratat afatgjata për të cilat Shoqëria arkëton primin në total për të gjithë afatin e kontratës, pjesa e mbetur e kontratës afatgjatë të sigurimit me debitorët, që nuk është njohur në periudhën raportuese pasqyrohet si angazhim i Shoqërisë për vitet e ardhshme.

Rezerva për primin e pafituar

Primet e pafituara përfshijnë atë pjesë të primeve të shkruara bruto, me periudhat e rrezikut pas datës së raportimit. Primet e marra janë llogaritur në baza ditore pro rata. Primi i pafituar llogaritet nga prime të shkruara bruto, dhe shtyhet për t'u njohur në periudhat pasardhëse si rezervë për primet e pafituara. Për llogaritjen e rezervës së primit të pafituar janë marrë në konsideratë kontratat e shitura për të gjitha linjat e biznesit të jetës. Në llogaritjen e rezervës së primit të pafituar është përdorur metoda e ditëve ekzakte mbi primin bruto të sigurimit dhe nuk janë konsideruar në llogaritjet për rezervën e primit të pafituar policat e kthyera apo anuluar.

Në lidhje me produktin e Jetës së Debitorit, rezerva e primit është llogaritur me metodat aktuariale për provigjonet, duke marrë në konsideratë shumën e sigurimit të jetës së debitorit si dhe tabelat e mortalitetit për çdo moshë dhe gjini.

ALBSIG JETE SHA

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

d) Njohja dhe matja e kontratave të sigurimit (vazhdim)

Primet e risigurimit

Primet e risigurimit njihen si shpenzim në përputhje me modelin e shërbimit të marrë nga risiguresi. Nëse një policë sigurimi anulohet, primi i mbetur për t'u paguar përfshihet në të ardhurat nga primet.

Lëvizja e detyrimeve nga sigurimi, nëse ka ndonjë, njihet si e ardhur neto e pjesës së risiguresit. Shoqëria ka marrëveshje risigurimi për ekspozimet e sigurimit të Jetës së Debitorit.

Të ardhura nga investimet

Të ardhurat nga interesi për letrat me vlerë dhe depozitat njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes, në masën proporcionale që i takon periudhës raportuese dhe llogariten duke përdorur metodën e Normës Efektive të Interesit (NEI). Tarifat dhe komisionet që janë pjesë përbërëse e yield-it efektiv të aktivitetit financiar njihen si një rregullim në NEI të instrumentit. Shoqëria ka investime në depozita.

Kostot e shtyra të marrjes në sigurim

Kostot e drejtpërdrejta dhe indirekte të krijuara gjatë periudhës financiare që rrjedhin nga blerja ose ripërtëritja e kontratave të sigurimit, shtyhen deri në masën që këto kosto janë të rikuperueshme nga primet e ardhshme nga kontrata e sigurimit. Të gjitha shpenzimet e tjera të blerjes njihen si shpenzime kur ndodhin.

Kostot e shtyra të marrjes në sigurim dhe të ardhurat e shtyra nga komisionet përfaqësojnë përqindjen e kostove të ndodhura të marrjes në sigurim dhe të ardhurave që korrespondojnë me rezervën e primit të pafiturar. Të ardhurat shtyhen dhe njihen si të ardhura kur shërbimet përkatëse do ofrohen dhe njihen në pasqyrën e fitim humbjes së vitit.

ii. Dëmet

Dëmet që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të jetës

Dëmet përbehen nga pagesat e bëra gjatë vitit financiar së bashku me ndryshimin në rezervën për dëmet. Dëmet bruto të paguara përfshijnë të gjitha shpenzimet e bëra për këto dëme. Rikuperimet në avancë nga risigurimi paraqiten më vete si aktive. Rikuperimet nga risigurimi dhe të tjera vlerësohen në mënyrë të ngjashme me vlerësimin e dëmeve pezull.

Rezerva për dëmet

Rezerva për dëmet janë shumat e të gjitha dëmeve që kanë lindur gjatë periudhës financiare aktuale dhe asaj të mëparshme të cilat nuk janë paguar në përfundim të vitit fiskal. Rezerva përfshin edhe dëmet e ndodhura, por të raportuara (IBNR) në atë datë.

a) *Rezerva për dëmet* – RBNS: Për përlllogaritjen e rezervës së dëmeve është përdorur metoda “Rast pas Rasti” mbështetur në vlerën e rezervës të llogaritur nga specialisti i dëmeve.

b) *Rezerva për dëmet* – IBNR: Duke konsideruar që Shoqëria nuk ka historik të dëmeve nuk është i mundur aplikimi i metodës së trekëndëshit për vlerësimin e IBNR derisa të ketë një historik dëmsh për aplikimin e kësaj metode. Shoqëria e ka llogaritur IBNR në varësi të dëmeve të raportuara dhe duke gjykuar përsa i përket IBNR se Debitorit që zë peshën kryesore të produkteve dhe ka rritje të ndjeshme me vitin të kaluar, duke përfshirë dhe risqe të tjera të ndërlidhura me produktin që mund të hasen në vazhdimësi.

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)**d) Njohja dhe matja e kontratave të sigurimit (vazhdim)***Risigurimi*

Shoqëria çedon risigurimin në rrjedhën normale të biznesit me qëllim që të limitojë humbjen neto nëpërmjet diversifikimit të rrezikut. Marrëveshjet e risigurimit nuk i heqin Shoqërisë detyrimet ndaj policëmbajtësve. Primet e çeduara dhe përfitimet e rimbursimit paraqiten në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse dhe pasqyrën e pozicionit financiar me baza bruto. Kontratat nga të cilat lind një transferim i rrezikut të sigurimit kontabilizohen si sigurim. Shumat e rigjeneruara nga këto kontrata njihen në të njëjtin vit me dëmin.

Aktivitet e risiguara përfshijnë balanca detyrimi nga shoqëria risiguruese për detyrimet e primeve të çeduara si dhe shuma të rikuperueshme nga dëmet e paguara. Këto shuma, nëse ka të tilla, klasifikohen si shuma të arkëtueshme dhe paraqiten në pasqyrat financiare. Llogaritë e arkëtueshme nga kontratat e risigurimit përfshijnë komisionet e risigurimit nga primet e çeduara të risiguruesit dhe të arkëtueshmet nga shoqëria risiguruese në përputhje me dëmin e paguar. Këto klasifikohen si llogari të arkëtueshme dhe paraqiten të veçanta. Aktivitet e risigurimit vlerësohen për zhvlerësim në çdo datë raportimi. Këto aktive zhvlerësohen nëse ka evidencë objektive, si pasojë e një ngjarje që ka lindur pas njohjes fillestare, për të cilat Shoqëria nuk mund të rimarrë të gjitha shumat që i detyrohen dhe për një ngjarje e cila ka një impakt të matur në mënyrë të besueshme për shumat të cilat Shoqëria do të marrë nga risiguruesi.

iii. Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve

Në çdo datë raportimi shoqëria kryen testimin për tu siguruar për mjaftueshmërinë e rezervave të dëmeve. Testimet kryesore që kryen janë: Analiza e Raportit të Dëmeve dhe Analiza e Zhvillimit të Provigjoneve të Dëmeve.

Analiza e raportit të dëmeve kryhet çdo vit dhe individualisht në pjesën më të madhe të linjave të biznesit. Llogaritja bëhet vetëm mbi dëmet që përfshijnë edhe koston e marrjes në sigurim dhe kosto të tjera të jashtme të lidhura me dëmin. Në kryerjen e kësaj analize shoqëria merr në konsideratë parashikimet aktuale të rrjedhjeve dalëse të parasë. Shoqëria nuk i skanton këto flukse të parashikuara të parasë pasi shumica e dëmeve priten të paguhën brenda vitit.

Në vazhdim, shoqëria kryen një analizë vjetore të zhvillimit të provigjonimit të dëmeve për vlerësimin e metodologjisë së provigjonimit. Kjo analizë kryet mbi RBNS dhe IBNR në baza individuale dhe të kombinuara. Në rast se analiza shfaq mospërputhje të madhe, korrigjimet e duhura bëhen në metodën e provigjonimit. Nëse identifikohet një pamjaftueshmëri e rezervave, ajo do t'i ngarkohet menjëherë shpenzimeve duke krijuar një rezervë risku të paskaduar nga humbjet që rezultojnë nga Testi i Mjaftueshmërisë së Rezervave.

iv. Kostot e shtyra të marrjes në sigurim

Kostot e shtyra të marrjes në sigurim llogariten në bazë të policave të sigurimit të jetës me kursim, afateve të rregullta dhe afateve të veçanta. Për policat Jeta me Afat, kostot e shtyra të marrjes në sigurim llogaritet në bazë të komisionit të përcaktuar në baza individuale të policave. Komisioni i paguar për çdo policë është i ndarë nga shuma e shkruar e asaj police. Raporti që rezulton është shumëfishuar me rezervat e primit të pafituar të primeve bruto të shkruara. Si rezultat, kostot e marrjes shtyhen për kohëzgjatjen e policave përkatëse. Për policat e sigurimit me kursim, kostot e shtyra të marrjes në sigurim janë llogaritur në përputhje me Standardet e kostove të shtyra të marrjes në sigurim të Shoqërisë. Shpenzimet e marrjes përcaktohen si kosto që rrjedhin nga blerja e kontratave të reja të sigurimit, duke përfshirë kostot direkte, siç janë komisionet e blerjes dhe koston e hartimit të dokumentit të sigurimit, si dhe shpenzimet administrative të ndara lidhur me përpunimin e propozimeve dhe lëshimin e politikave.

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

e) Instrumentet financiare

(i) Njohja

Shoqëria fillimisht njeh llogarite e arketueshme dhe depozitat në datën kur ato janë krijuar. Të gjitha detyrimet dhe aktivet financiare njihen në datën e transaksionit sipas së cilit Shoqëria bëhet palë e detyrimeve kontraktore të instrumentit.

(ii) Çregjistrimi

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar nëse humbet kontrollin mbi flukset e ardhshme të parasë ose transferon të drejtat për të marrë flukset kontraktuale të parasë nga aktivet financiare në transaksione në të cilat i gjithë rreziku dhe përfitimet nga aktivet financiare është transferuar. Çdo interes nga aktivi financiar i transferuar që është krijuar ose mbajtur nga Shoqëria njihet si aktiv ose detyrim i veçantë. Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shuhet, anulohen ose maturohen.

(iii) Netimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare mund të netohen dhe tepricat neto të paraqiten në bilanc vetëm kur Shoqëria ka të drejta ligjore për të netuar shumat dhe ka qëllim të arkëtojë ose të mbylli aktivin apo detyrimin neto në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten të netuara kur lejohet nga Standardet e Kontabilitetit, ose për fitime dhe humbje që lindin nga transaksione me natyrë të njëjtë përgjatë aktivitetit të Shoqërisë.

(iv) Matja me kosto të amortizuar

Kosto e amortizuar e një aktivi financiar është vlera me të cilën aktivi financiar ose detyrimi financiar është matur në njohjen fillestare, duke zbritur këstet e paguara, plus ose minus amortizimin kumulativ që rezulton nga përdorimi i metodës së interesit efektiv duke marrë parasysh ndonjë diferencë midis vlerës së njohur në fillim dhe vlerës në maturim si dhe humbjet nga rënia në vlerë.

(v) Matja me vlerë të drejtë

Vlera e drejtë është shuma për të cilën një aktiv mund të këmbëhet ose një detyrim mund të vendoset midis palëve që kanë njohurinë dhe mundësinë të kryejnë transaksione në marrëdhënie normale tregu në datën e matjes. Kur është e mundshme, Shoqëria e mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar për këtë instrument në tregje aktive. Tregu konsiderohet si aktiv nëse transaksionet për aktivin ose pasivin zhvillohen me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacionin e çmimeve në baza të vazhdueshme. Nëse nuk ka çmim të kuotuar në një treg aktiv, atëherë Shoqëria përdor teknikat e vlerësimit që maksimizojnë përdorimin e inputeve përkatëse të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve që nuk vëzhgohen. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në çmimet e një transaksioni.

Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit - d.m.th. vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë. Nëse Shoqëria konstaton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk evidentohet as nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose pasiv identik ose të bazuar në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregjet e vëzhguara, atëherë instrumenti financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë, të rregulluar për të shtyrë diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Më pas, ky ndryshim njihet në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme gjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se kur vlerësimi mbështetet tërësisht nga të dhënat e tregut të vëzhgueshëm ose transaksioni mbyllet.

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

e) Instrumentet financiare (vazhdim)

(vi) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë

Në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare Shoqëria vlerëson nëse ka evidenca objektive për rënien në vlerë të aktiveve financiare. Aktivet financiare pësojnë rënie në vlerë kur evidenca objektive dëshmon që një ngjarje me pasojë humbje ka ndodhur pas vlerësimit të mëparshëm të aktivit, si dhe kjo ngjarje ndikon në flukset e mjeteve monetare të vlerësueshme në mënyrë të besueshme.

Shoqëria merr në konsideratë evidenca për rënien në vlerë të aktiveve financiare specifike ose në grup të aktiveve. Të gjitha aktivet individualisht të rëndësishme testohen veçmas për humbjen e mundshme në vlerë, por që nuk është identifikuar ende. Të gjitha aktivet që nuk konsiderohen të jenë individualisht të rëndësishëm grupohen dhe vlerësohen së bashku me aktive me karakteristika të ngjashme (të mbajtura me kosto të amortizuar) për rënie në vlerë.

Si evidencë objektive për rënie në vlerë të mundshme të aktiveve në pasqyrat financiare mund të përmendet mosshlyerja në kohë apo shkelja e termave nga një debitor, ristrukturimi i një kredie/paradhënie të dhënë nga Shoqëria me terma të cilat në kushte të tjera nuk do të ishin konsideruar, tregues për falimentimin e mundshëm të një debitori ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si ndryshimi në përkeqësim në statusin e arkëtueshmërisë së një debitori ose kreditori, apo kushte ekonomike që ndikojnë në përkeqësim të grupit të aktiveve.

e) Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to përfshijnë balancat e gjendjes në arkë, mjetet monetare të depozituara në banka të nivelit të dytë dhe investime afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe me maturitet deri në tre muaj ose më pak që nga momenti i blerjes.

f) Depozitat me afat

Depozitat me afat paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar me shumën e principalit të tyre dhe klasifikohen sipas maturitetit. Depozitat me afat me maturitet më të vogël se tre muaj klasifikohen si ekuivalentë të mjeteve monetare, ato me maturitet midis tre dhe dymbëdhjetë muaj klasifikohen si investime në depozita me afat.

g) Letra me Vlerë

Letrat me vlerë janë investime borxhi të cilat Shoqëria ka për qëllim dhe aftësi t'i mbajë deri në maturim dhe që janë klasifikuar si aktive të mbajtura deri në maturim. Investimet të cilat kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe të cilat synohen të mbahen deri në maturim dhe si rrjedhim maten me kosto të amortizuar, minus provigjonin për rënien në vlerë. Kosto e amortizimit llogaritet duke marrë në konsideratë ndonjë skontim ose prim në blerje. Primet dhe skontimet në investimet e projektuara si të mbajtura deri në maturim amortizohen sistematikisht gjatë maturitetit duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe regjistrohen si të ardhura nga interesi.

h) Llogaritë e arkëtueshme sigurimi dhe të tjera

Kreditë dhe të drejtat e tjera njihen në fillim me vlerë të drejtë dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv minus provigjonin për zhvlerësim. Provigjoni për zhvlerësimin e kredive dhe të drejtave të tjera të arkëtueshme krijohet kur ka një evidencë objektive që shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve fillestare. Të drejtat e arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit që vijnë nga mbajtësit e policave të sigurimit gjithashtu klasifikohen në këtë kategori dhe rishikohen për zhvlerësim si pjesë e rishikimit për zhvlerësim të kredive dhe të drejtave të tjera të arkëtueshme.

ALBSIG JETE SHA

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

i) Njohja e të ardhurave

i. Prime të shkruara bruto

Primet e shkruara bruto janë njohur siç shpjegohet në Shënimin 3.d.

ii. Të ardhura nga interesi

Të ardhurat nga interesi për aktivet financiare është njohur duke përdorur metodën e interesit efektiv.

j) Shpenzimet për personelin

Shoqëria paguan vetëm kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të cilat u sigurojnë punonjësve përfitime pensioni pas shkëputjes nga puna. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për të përcaktuar kufirin e vendosur minimal për pensionet në vendet përkatëse sipas një plani të përcaktuar kontributesh pensioni. Kontributet e Shoqërisë për planin e pensionit paraqiten në pasqyrën përmbledhëse individuale të të ardhurave kur ndodhin.

Leja vjetore e paguar

Shoqëria njeh si detyrim shumë të pa skontuar të kostove të parashikuara në lidhje me lejen vjetore që pritët të paguhet në shkëmbim të shërbimeve të punonjësve për periudhën e përfunduar. Për vitin 2024 punonjësit e shoqërisë i kanë përfunduar lejet e tyre vjetore.

k) Shpenzimet administrative

Shpenzimet administrative njihen kur ato ndodhin.

l) Detyrime të tjera

Detyrime të tjera njihen me koston e tyre.

m) Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afat-gjata materiale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje tjetër nga zhvlerësimi përveç ndërtimeve në proces të cilat maten me vlerën e rivlerësuar. Kostoja historike përfshin shpenzime që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me blerjen e këtyre elementeve. Kur pjesë të një aktivi kanë diferenca mbi jetëgjatësinë e dobishmërinë, ato njihen si aktive të ndara (komponentë të rëndësishëm) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitja përcaktohen duke krahasuar shumën e marra me vlerën e mbetur, dhe duke përfshirë diferencën në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave në zërin 'Fitime/(humbje) të tjera'.

Kostot e mëpasshme

Kostot e mëpasshme përfshirën në vlerën e aktivit ose njihen si një aktiv i veçantë vetëm kur është e mundshme që përfitimet të ardhshme do të rrjedhin nga ky aktiv dhe kostoja mund të matet në mënyrë të besueshme. Vlera kontabël e pjesës së zëvendësuar nuk njihet. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtja i ngarkohen fitimit dhe humbjes së periudhës financiare në të cilën ato kryhen.

ALBSIG JETE SHA

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

m) Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Amortizimi

Amortizimi për ndërtesat dhe përmirësimet e infrastrukturës llogaritet duke përdorur metodën lineare në përputhje me jetën e dobishme ekonomike të aktivit ndërsa amortizimi për zërat e tjerë të aktiveve llogaritet duke përdorur metodën me vlerën e mbetur në përputhje me jetën e dobishme ekonomike të aktivit. Toka dhe aktivet në ndërtim nuk amortizohen. Amortizimi vjetor i aktiveve afatgjata materiale sipas jetëgjatësisë së dobishme të parashikuar për periudhën e mëparshme dhe aktuale paraqitet si më poshtë:

Kategoria	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Pajisje zyre	20%	20%
Pajisje kompjuterike dhe programe	25%	25%

n) Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivitet jo-materiale të shoqërisë të ndryshme nga emri i mirë kanë jetë të dobishme të caktuar dhe kryesisht përfshijnë programe kompjuterike të kapitalizuara, patenta, marka tregtare dhe licencat. Licencat e programeve kompjuterike, patentat dhe markat tregtare kapitalizohen në bazë të shpenzimeve të bëra për t'i marrë dhe vënë në përdorim. Kostot e zhvillimit që lidhen direkt me programe të identifikueshme dhe unike që kontrollohen nga Shoqëria regjistrohen si aktive jo-materiale nëse rrjedhja e përfitimeve ekonomike në rritje i tejkalon kostot.

Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave bazuar metodën lineare duke përdorur normat fiskale për amortizimin e aktiveve të patrupëzuara, një muaj pas blerjes së aktivit. Jeta e dobishme e aktiveve rishikohet, dhe bëhen rregullimet e nevojshme, në çdo datë bilanci. Norma e amortizimit është 15% bazuar në vlerën e mbetur të aktivit.

Fitimet dhe humbjet nga shitja përcaktohen duke krahasuar shitjet me vlerën e mbetur dhe diferencat përfshihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave.

o) Zhvlerësimi

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë shqyrtohet në çdo datë bilanci për të përcaktuar nëse ekziston ndonjë tregues për rënie në vlerë. Në qoftë se ekziston ndonjë tregues i tillë, drejtimi vlerëson vlerën e rikuperueshme, e cila përcaktohet si vlera më e lartë e një aktivi me vlerën e drejtë minus kostot për shitje dhe vlerën e saj në përdorim. Vlera kontabël është zvogëluar në shumën e rikuperueshme dhe humbja nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje për vitin.

Një humbje nga zhvlerësimi e njohur për një aktiv në vitet e mëparshme kthehet kur është e përshtatshme nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e aktivit në përdorim ose vlerën e drejtë minus kostot për shitje.

p) Kapitali

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Kapitali i Shoqërisë mbahet me vlerën ekuivalent në Lek të kontributit të marrë në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Kapitali i nënshkruar i Shoqërisë njihet me vlerën nominale të tij.

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

q) Provigjonet

Një provigjon njihet kur Shoqëria ka një detyrim aktual ose konstruktiv si rezultat i një ngjarjeje të shkuar dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike të kërkohej për të shlyer detyrimin. Provigjonet përcaktohen duke zbritur flukset e ardhshme të parave të gatshme në normën para tatimit. Dispozitat pasqyrojnë vlerësimet aktuale të tregut për vlerën kohore të parasë dhe, kur është e përshtatshme, rreziqet specifike për detyrimin.

r) Tatimi

Tatimi mbi fitimin është njohur në pasqyrën individuale të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe paraqet shumën e tatimit aktual dhe të shtyre.

(i) Tatim fitimi aktual

Tatimi aktual është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, i cili llogaritet duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e raportimit dhe ndonjë rregullim të tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Fitimi fiskal ndryshon nga fitimi neto i raportuar në pasqyrën individuale të të ardhurave dhe shpenzimeve sepse përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshme ose të zbritshme në vitet e tjera dhe gjithashtu përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve që nuk janë asnjëherë të tatueshme ose të zbritshme.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë kontabilizohet duke përdorur metodën e detyrimeve të bilancit kontabël dhe llogaritet si tatimi i pritshëm për tu paguar ose për tu arkëtuar nga diferencat e përkohshme midis vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime fiskale. Shuma e tatimit të shtyrë të lejuar bazohet në mënyrën e parashikuar të realizimit ose pagesës të shumave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve, duke përdorur normat fiskale të miratuara ose që priten të miratohen me siguri në datën e raportimit.

(iii) Detyrimet e shtyra tatimore

Detyrimet e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme dhe aktivet tatimore të shtyra njihen vetëm nëse është e mundur që në të ardhmen do të ketë përfitime fiskale kundrejt të cilave do të mund të shfrytëzohen diferencat e përkohshme. Aktivet tatimore të shtyra reduktohen kur nuk ka mundësi që përfitimet e lidhura tatimore do të realizohen. Tatimi i shtyrë llogaritet me normën e taksës që është parashikuar për tu zbatuar në periudhën kur detyrimi paguhet ose aktivi të realizohet dhe ngarkohet në pasqyrën përmbledhëse individuale të të ardhurave, përveç kur është e lidhur me zërat e ngarkuar direkt në kapital. Në të tilla raste tatimi i shtyrë është gjithashtu pjesë e kapitalit.

s) Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përbëhen nga aksionarë dhe drejtorët e shoqërisë, së bashku me entitete që ata kontrollojnë, të cilët mund të ushtrojnë influencë të konsiderueshme në operacionet dhe menaxhimin e shoqërisë. Duke konsideruar çdo palë të mundshme të tretë vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo vetëm forma ligjore.

t) Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas datës së bilancit që ofrojnë informacion shtesë për pozicionin e shoqërisë në datën e pasqyrës së pozicionit financiar (veprimet rregulluese), janë të reflektuara në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje për veprime rregulluese janë pasqyruar në shënimet shpjeguese kur janë materiale.

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

u) Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen në shënimet shpjeguese nëse mundësia e konsumimit të burimeve që kanë përfitime ekonomike është e ulet. Aktivët e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shënimet sqaruese kur mundësia e të ardhurave ekonomike është e mundshme.

Shuma e humbjes së kushtëzuar njihet si provigjon nëse është e mundshme që ngjarje të ardhshme do të konfirmojnë provigjonin, një detyrim njihet në ditën e pasqyrës së pozicionit financiar kur një vlerësim i pranueshëm i humbjes mund të bëhet në mënyrë të besueshme.

v) SNRF 16 Qiratë

SNRF 16, Qiratë është efektive për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janar 2019. SNRF 16 sjell një model të vetëm kontabël të paraqitjes në bilanc të qirave nga qiramarrësit. Një qiramarrës njih një aktiv për të drejtën e përdorimit që përfaqëson të drejtën e tij të përdorimit të aktivit bazë dhe një detyrim qiraje që përfaqëson detyrimin e tij për të bërë pagesa qiraje. Ka përjashtime nga njohja për qiratë afatshkurtra dhe qiratë e aktiveve me vlerë të ulët. Kontabiliteti për qiradhënësin do të mbetet kryesisht i pandryshuar dhe do të ruhet dallimi ndërmjet qirasë operative dhe financiare.

4. Vlerësimet dhe gjykimet kontabël

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, pasiveve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlerësimet dhe supozimet e ndërlidhura bazohen në përvojën historike dhe në faktorë të tjerë që besohet të jenë të arsyeshëm sipas rrethanave dhe informacioneve në dispozicion në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare, rezultatet e të cilave formojnë bazën për të bërë gjykime mbi kryerjen e vlerat e aketëve dhe pasiveve që nuk janë të dukshme nga burime të tjera. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet themelore shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimi i vlerësimeve kontabël njihet në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet nëse ndryshimi ndikon vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat e ardhshme nëse ndryshimi ndikon në periudhat aktuale dhe në të ardhmen.

Gjykimet e bëra nga drejtimi në zbatimin e SNRF-ve që kanë efekt të rëndësishëm në pasqyrat financiare dhe vlerësimet me një rrezik të konsiderueshëm të përshtatjes materiale në vitin e ardhshëm janë diskutuar më poshtë.

Humbja nga zhvlerësimi i të arkëtueshmeve

Shoqëria rishikon llogaritë e arkëtueshme të sigurimit dhe të tjera për të vlerësuar zhvlerësimin në baza vjetore. Në përcaktimin nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në fitim ose humbje, shoqëria bën gjykime nëse ka ndonjë të dhënë të dukshme që tregojnë se ka një rënie të matshme në flukset e ardhshme të vlerësuar të mjeteve monetare nga një grup llogarish të arkëtueshme para rënies që mund të jetë identifikuar me një debitor individual në atë portofol. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të debitorit që lidhen me mungesat në aktivet në grup. Menaxhimi i shfrytëzon vlerësimet bazuar në përvojën historike të humbjeve për aktivet me karakteristika të rrezikut të kredisë dhe evidenca objektive të zhvlerësimit të ngjashme me ato në portofol kur cakton flukset e ardhshme të parasë.

Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimin e vijimësisë

Shoqëria vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

Vlerësimi për primet e pafituara dhe detyrimet e kontratave të sigurimit

Për llogaritjen e provigjonit të primit të pafituar të Debitorit është përdorur Tabela e Vdekshmërisë e marrë nga INSTAT, e cila i ka tarifat më të larta sesa tarifat e miratuara dhe të rëna dakord nga risiguruesi. Kjo është bërë për të qenë sa më prudent. Tabela e vdekshmërisë është zbatuar vetëm për shumën e siguruar për Jetën. Për shumën e siguruar nga Aksidentet është përdorur metoda e ditëve ekzakte mbi primin bruto të sigurimit. Për llogaritjen e provigjonit të primit të pafituar për kontratat e tjera të sigurimit, përveç debitorit është përdorur metoda e ditëve ekzakte mbi primin bruto të sigurimit. Shoqëria vlerëson rezervat IBNR në kontratat afatshkurtra të sigurimit të jetës. IBNR për llogaritjet mbi bazën e dëmeve të ndodhura.

5. Administrimi i rreziqeve

a. Rreziku i sigurimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut aktuarial dhe marrjes në sigurim që rrjedhin nga një gamë e gjerë të produkteve të jetës të ofruara për konsumatorët. Rreziku i sigurimit ka të bëjë me pasigurinë e biznesit të sigurimit. Komponentët më të rëndësishëm të rrezikut të sigurimit janë rreziku i primit dhe rreziku i rezervës. Kjo ka të bëjë me shqetësimin në lidhje me përshtatshmërinë e nivelit të normës së primit të sigurimit dhe mjaftueshmërinë e provizioneve për detyrimet e sigurimit dhe baza e kapitalit.

Rreziku i primit është i pranishëm sapo është lëshuar polica e sigurimit, dhe është rreziku që shpenzimet dhe humbjet e shkaktuara të jenë më të larta se primi i marrë. Rreziku rezervës paraqet rrezikun që niveli absolut i rezervave teknike është i nënvlerësuar ose që pretendimet faktike do të luhaten rreth vlerës statistikore të përlogaritur.

Komponentët e rrezikut të marrjes në sigurim të biznesit të jetës përfshijnë edhe rrezikun biometrik (duke përfshirë vdekshmërinë, jetëgjatësinë, sëmundshmërinë dhe paaftësinë) dhe rrezikun e gabimit. Rreziku i gabimit lidhet me normën më të lartë të paparashikuar ose normën më të ulët të gabimeve të politikave, anulimeve, ndryshimet në statusin e pagesës (ndërprerjen e pagesës së primit) dhe të ndërprerjeve.

Risigurimi blihet nga Shoqëria për të ulur rrezikun potencial nga humbjet si pasojë e ngjarjeve të mëdha individuale ose katastrofa dhe gjithashtu për të patur akses nga specialistë të rreziqeve dhe asistencë në administrimi e kapitalit. Policat e risigurimit nënshkruhen me risigurues të aprovuar në bazë proporcionale ose në bazë të marrëveshjeve për humbjen.

Ngjarjet e sigurimit janë të rastësishme dhe numri aktual i dëmeve dhe përfitimeve mund të ndryshojë nga viti në vit nga niveli i caktuar nga teknikat statistikore. Eksperienca tregon se sa më i madh të jetë portofoli i kontratave të njëjta të sigurimit aq më e vogël do të jetë varianca relative e rezultateve. Gjithashtu, një portofol i diversifikuar më shumë ka më pak mundësi që të ndikohet nga ndryshimet në portofol.

Risigurimi përdoret për të administruar rrezikun e sigurimit. Megjithatë kjo nuk heq përgjegjësinë e Shoqërisë si siguruesi kryesor. Nëse risiguruesi nuk paguan një dëm për arsye të ndryshme, Shoqëria është e detyruar që të paguajë policëmbajtësin për detyrimin. Aftësia paguese e risiguruesit analizohet çdo vit duke rishikuar pozicionin e tyre financiar përpara së të nënshkruajnë kontratën. Shoqëria ka çeduar rrezikun e sigurimit për të limituar ekspozimin nga humbjet nga kontratat e nënshkruara dhe të minimizojë efektin e humbjes nga sigurimi i jetës, duke nënshkruar kontrata risigurimi me Swiss Re Europe S.A. Niederlassung Deutschland.

b. Rreziku i risigurimit

Shoqëria çedon rrezikun e sigurimit që të limitojë ekspozimin e humbjeve nën marrëveshje të ndara për çdo lloj sigurimi. Këto marrëveshje risigurimi e shpërndajnë rrezikun dhe minimizojnë efektin e humbjes. Shuma e secilit rrezik të mbetur varet nga vlerësimi që Shoqëria i bën rreziqeve specifike, i cili është subjekt në disa rrethana, i limiteve maksimale bazuar në karakteristikat e mbulimit. Nën termat e marrëveshjes së risigurimit, risiguruesi bie dakord që të rimbursojë shumën e çeduar në rastin e dëmeve të paguara.

Megjithatë, Shoqëria mbetet e detyruar ndaj policëmbajtësve të saj në lidhje me sigurimin e çeduar nëse risiguruesi nuk përmbush detyrimet e tij.

Përqendrimi i provigjoneve teknike dhe të dëmeve sipas llojit është përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

ALBSIG JETE SHA

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

5. Administrimi i rreziqeve (vazhdim)

b. Rreziku i risigurimit (vazhdim)

Lloji i rezervave	31 dhjetor 2024		
	Bruto	Risiguruesi	Neto
Rezervat për primet e pafituar	164,885,779	78,279,148	86,606,631
Rezerva teknike për dëmet	85,277,825	-	85,277,825

Lloji i rezervave	31 dhjetor 2023		
	Bruto	Risiguruesi	Neto
Rezervat për primet e pafituar	121,534,750	41,845,020	79,689,730
Rezerva teknike për dëmet	42,588,392	-	42,588,392

Përqendrimi i primeve të pafituara sipas llojit të kontratës është përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Llojet e kontratave	31 dhjetor 2024		
	Bruto	Risiguruesi	Neto
Sigurimi i jetës së debitorit	126,892,914	78,279,148	48,613,766
Sigurimi i jetës në grup	18,638,132	-	18,638,132
Sigurimi sipas skemave 'cash plan'	19,354,454	-	19,354,454
Sigurimi i jetës dhe shëndetit në udhëtim	280	-	280

Llojet e kontratave	31 dhjetor 2023		
	Bruto	Risiguruesi	Neto
Sigurimi i jetës së debitorit	86,485,666	41,845,020	44,640,646
Sigurimi i jetës në grup	16,506,564	-	16,506,564
Sigurimi sipas skemave 'cash plan'	18,496,294	-	18,496,294
Sigurimi i jetës dhe shëndetit në udhëtim	46,226	-	46,226

c. Rreziku i normave të interesit

Rreziku i normave të interesit është i ndikuar nga rreziku i luhatjeve të vlerave të instrumenteve financiare si pasojë e ndryshimeve në tregun e normave të interesit dhe rreziku që maturitetet e interesave në lidhje me aktivet të ndryshojë nga maturiteti i interesave të lidhura me detyrimet e përdorura për këto aktive. Kohëzgjatja për të cilën është fiksuar norma e interesit mbi një instrument financiar tregon se ndaj çfarë niveli rreziku të normave të interesit është ekspozuar. Aktivet dhe pasivet e shoqërisë kanë norma interesi të tregut.

Shoqëria mban një shumë jo të konsiderueshme të detyrimeve interes mbartëse dhe rreziku i shkaktimit të kostove të rëndësishme që vijnë si shkak i rritjes në normat e interesit nuk është domethënës. Në krahun tjetër, aktivet interes mbartëse kanë normë interesi fikse.

ALBSIG JETE SHA

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

5. Administrimi i rreziqeve (vazhdim)

d. Rreziku i administrimit të kapitalit

Struktura kapitale e shoqërisë konsiston në kapitalin aksionar të shoqërisë që përbëhet nga kapitali themeltar, rezervat dhe fitimet e mbartura. Objektivat kryesore të Shoqërisë për administrimin e kapitalit janë:

- të jetë në përputhje me kërkesat nga entet rregullatore Shqiptare për tregun e sigurimit duke mbajtur kapital mbi limitin e kërkuar;
- të sigurojë mundësinë e vijimësisë së aktivitetit të Shoqërisë në mënyrë që ajo të mund të gjenerojë fitime për aksionarët dhe përfitime për grupet e interesit të tjera.

Në përputhje me ligjin shqiptar Nr. 52/2014 "Për sigurime dhe risigurime", datë 4 korrik 2014, Shoqëria e sigurimit është e detyruar të përmbushë kërkesat e nenit 80 dhe 81. Sipas këtyre kërkesave, kapitali i përgjithshëm i Shoqërisë duhet të jetë së paku shuma e aftësisë paguese të llogaritur (d.m.th.. më e lartë e fondit të garancisë dhe 150% e aftësisë paguese të llogaritur në bazë të të njëjtit ligj). Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit të Shoqërisë është 142.9% në 2023 (2023: 120.18%).

Shoqëria menaxhon kapitalin për të siguruar nivelin e duhur të kapitalit në mënyrë që të jetë e aftë të vazhdojë në vijimësi dhe të përmbushë kërkesat rregullatore të kapitalit, ndërkohë që maksimizon kthimin tek aksionaret nëpërmjet optimizimit të gjendjes së detyrimeve dhe kapitalit.

e. Rreziku nga kurset e këmbimit

Primet janë shprehur në tre valuta kryesore (Lek, USD dhe Euro). Tabela e mëposhtme paraqet një analizë sasiore të rrezikut valutor të shoqërisë më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 për luhatje të mundshme në kurset e këmbimit.

		2024 në Lek	2023 në Lek
	Ndikimi		
EUR rritet me 10% ndaj Lekut	Fitim	13,176,084	13,308,925
EUR ulet me 10% ndaj Lekut	Humbje	(13,176,084)	(13,308,925)
USD rritet me 10% ndaj Lekut	Fitim	499,048	4,190
USD ulet me 10% ndaj Lekut	Humbje	(499,048)	(4,190)

ALBSIG JETE SHA

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

5. Administrimi i rreziqeve (vazhdim)**e. Rreziku nga kurset e këmbimit (vazhdim)**

Tabela e mëposhtme paraqet një analizë sasiore të rrezikut valutor të Shoqërisë më 31 dhjetor 2024:

	LEK	EUR	USD	Total
Aktive Financiare				
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	31,817,825	14,829,535	116,486	46,763,846
Depozita me afat me bankat	402,000,000	134,465,500		536,465,500
Llogari të arkëtueshme sigurimi, neto	63,189,502	14,435,401	4,873,992	82,498,895
Te tjera llogari të arkëtueshme	1,120,867	-	-	1,120,867
Totali i aktiveve financiare	498,128,194	163,730,436	4,990,478	666,849,108
Detyrime Financiare				
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	450,000			450,000
Detyrim tatim fitimi	2,126,362			2,126,362
Detyrime të tjera	24,198,457	31,969,595	-	56,168,052
Totali detyrimeve financiare	26,774,819	31,969,595	-	58,744,414
Pozicioni valutor, neto	471,353,375	131,760,841	4,990,478	608,104,695

Tabela e mëposhtme paraqet një analizë sasiore të rrezikut valutor të Shoqërisë më 31 dhjetor 2023:

	LEK	EUR	USD	Total
Aktive Financiare				
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	24,424,839	7,468,992	41,904	31,935,735
Depozita me afat me bankat	390,912,838	139,209,477	-	530,122,315
Llogari të arkëtueshme sigurimi, neto	38,639,399	11,723,119	-	50,362,518
Te tjera llogari të arkëtueshme	2,136,441	33,803		2,170,244
Totali i aktiveve financiare	456,113,517	158,435,391	41,904	614,590,812
Detyrime Financiare				
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	3,297,239	-	-	3,297,239
Detyrim tatim fitimi	3,303,773	-	-	3,303,773
Detyrime të tjera	9,982,895	25,346,143	-	35,329,038
Totali detyrimeve financiare	16,583,907	25,346,143	-	41,930,050
Pozicioni valutor, neto	439,529,610	133,089,248	41,904	572,660,762

ALBSIG JETE SHA

Shënimet shpjeguese te pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

5. Administrimi i rreziqeve (vazhdim)

f. Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është i pranishëm në biznesin e Shoqërisë pasi aktivet e blera dhe detyrimet e shitura kanë karakteristika likuiditeti specifike. Por nëse Shoqërisë do t'i nevojiteshin likuiditete të mëdha brenda një kohe të shkurtër, nuk do të ishte e vështirë për sigurimin e tyre nisur nga mënyra e organizimit të investimit ne periudha maturimi të diversifikuara, bazuar në këtë analizë menaxhimi beson se nuk do të ndeshë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve financiare.

Gjithashtu Shoqëria e monitoron gjendjen e saj të likuiditetit çdo ditë, për të përmbushur detyrimet në kohën e duhur.

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 dhjetor 2024 është si më poshtë:

	Deri në 1 muaj	1 - 3 muaj	3 deri në 12 muaj	Mbi 12 muaj	Total
Aktive Financiare					
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	46,763,846	-	-	-	46,763,846
Depozita me afat me bankat		-	450,205,500	86,260,000	536,465,500
Llogari të arkëtueshme sigurimi, neto	82,498,895	-	-	-	82,498,895
Te tjera llogari të arkëtueshme	1,120,867	-	-	-	1,120,867
Totali I aktiveve financiare	130,383,608	-	450,205,500	86,260,000	666,849,108
Detyrime financiare					
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	450,000	-	-	-	450,000
Detyrim tatim fitimi	-	2,126,362	-	-	2,126,362
Detyrime të tjera	56,168,052	-	-	-	56,168,052
Totali detyrimeve financiare	56,618,052	2,126,362	-	-	58,744,414
Ekspozimi	73,765,556	-2,126,362	450,205,500	86,260,000	608,104,694
Ekspozimi kumulativ	73,765,556	71,639,194	521,844,694	608,104,694	

ALBSIG JETE SHA

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

5. Administrimi i rreziqeve (vazhdim)**f. Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 dhjetor 2023 është si më poshtë:

	Deri në 1 muaj	1 - 3 muaj	3 deri në 12 muaj	Mbi 12 muaj	Total
Aktive Financiare					
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	31,935,735	-	-	-	31,935,735
Depozita me afat me bankat	-	18,103,172	92,412,577	414,644,651	525,160,400
Llogari të arkëtueshme sigurimi, neto	50,362,518	-	-	-	50,362,518
Të tjera llogari të arkëtueshme	2,170,244	-	-	-	2,170,244
Totali i aktiveve financiare	84,468,497	18,103,172	92,412,577	414,644,651	609,628,897
Detyrime financiare					
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	3,297,239	-	-	-	3,297,239
Detyrim tatim fitimi	-	3,303,773	-	-	3,303,773
Detyrime të tjera	35,329,041	-	-	-	35,329,041
Totali detyrimeve financiare	38,626,280	3,303,773	-	-	41,930,053
Ekspozimi	45,842,218	14,799,400	92,412,577	414,644,651	567,698,846
Ekspozimi kumulativ	45,842,218	60,641,618	153,054,195	567,698,846	

ALBSIG JETE SHA

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

5. Administrimi i rreziqeve (vazhdim)

f. Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Shoqëria ekspozohet ndaj rrezikut të kredisë për aktivet financiare si: depozitat me afat, llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi. Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë për aktivet financiare nuk është i qenësishëm.

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 është si më poshtë:

Aktivet financiare	Shënimi	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	6	46,763,846	31,935,735
Depozita me afat me bankat	7	554,286,459	530,122,315
Llogari të arkëtueshme sigurimi, neto	8	82,498,895	50,362,518
Aktive të risigurimit	9	78,279,148	41,845,020
Te tjera llogari të arkëtueshme	10	1,120,867	2,170,244
Investime në tituj borxhi	11	34,630,000	35,776,000
Aksione në shoqëri të lidhura	14	69,000,000	69,000,000
Totali i aktiveve		866,579,215	761,211,833

Shoqëria menaxhon ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kredisë në mënyrë sistematike duke monitoruar llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi, ajo ka krijuar një rregull të brendshëm ku të gjitha policat e papaguara sipas kushteve të kontratave përkatëse anulohen, përveç rasteve ku ka siguri që shuma e arkëtueshme do të mbledhet.

Shoqëria administron ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kredisë duke monitoruar zbulimin ndaj instrumenteve të borxhit dhe depozitave. Shoqëria nuk ka identifikuar të dhëna objektive për zhvlerësim të mjeteve të tjera financiare në datën e raportimit, prandaj drejtimi i konsideron aktivet e tjera financiare si ekuivalentë të mjeteve monetare, depozitat me afat dhe pasuritë e tjera si as të kaluara e as të zhvlerësuar.

6. Mjete monetare dhe ekuivalentë me to

Mjete monetare dhe ekuivalentë me to më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 përfshijnë llogari rrjedhëse me bankat dhe janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Mjete monetare në arkë	-	-
Mjete monetare në bankë	46,763,846	31,935,735
<i>Mjete monetare në bankë në monedhë të huaj</i>	<i>14,946,020</i>	<i>7,510,896</i>
<i>Mjete monetare në bankë në monedhë vendase</i>	<i>31,817,826</i>	<i>24,424,839</i>
	46,763,846	31,935,735

ALBSIG JETE SHA

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

7. Depozita me afat me bankat

Depozitat me bankat më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 janë të detajuara si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Depozita për fondin e garancisë	536,465,500	525,160,400
Interesi i përlogaritur	17,820,959	4,961,915
	554,286,459	530,122,315

Në përputhje me nenin 81 të Ligjit Nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit”, lidhur me fondin e garancisë, Shoqëria mban të bllokuar për fondin e garancisë jo më pak se një të tretën e kufirit minimal të aftësisë paguese të përcaktuar ose 370,000 mijë Lek, cilado që është më e lartë. Fondi i garancisë duhet mbajtur në bono thesari dhe/ose depozita me afat jo më pak se një vit, të bllokuara për fond garancie.

Detajimi i depozitave me afat sipas bankave është si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Intesa San Paolo Bank	-	-
Credins Bank	30,000,000	32,077,600
Union Bank	43,268,750	42,946,200
Banka e Tiranës	135,157,750	121,023,800
Banka Amerikane e Investimeve	104,722,500	105,582,000
Banka Kombëtare Tregtare	102,500,000	97,500,000
ProCredit Bank	110,816,500	116,030,800
ABI Bank	10,000,000	10,000,000
	536,465,500	525,160,400

8. Llogari të arkëtueshme sigurimi, neto

Llogarite e arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Të arkëtueshme nga klientët	81,049,806	50,081,400
Të arkëtueshme nga shoqëritë e sigurimit	1,449,089	281,118
Provizione klientë të paarkëtueshëm	-	-
	82,498,895	50,362,518

ALBSIG JETE SHA

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

9. Aktive të risigurimit

Aktive të risigurimit më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Rezerva Teknike për Risiguruesin për primet	44,667,289	36,023,709
Rezerva Teknike për Risiguruesin për demet	33,611,859	5,821,311
	78,279,148	41,845,020

Ndryshimi në rezervën e primit të risiguruesit

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Sigurimi i jetës së debitorit	8,643,580	11,571,711
	8,643,580	11,571,711

Ndryshimi në rezervën e demit të risiguruesit

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Sigurimi i jetës së debitorit	27,790,548	5,821,311
	27,790,548	5,821,311

10. Te tjera llogari të arketueshme

Te tjera llogari të arketueshme deri më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Komisione brokerimi për t'u kthyer	149,621	1,540,244
Kreditore të tjerë	521,246	30,000
Paradhënie për punonjësit	450,000	600,000
	1,120,867	2,170,244

11. Investime në tituj borxhi

Investimet në tituj borxhi deri më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Fondi I investimit Albsig Invest	15,000,000	15,000,000
OTP bank obligacione	19,630,000	20,776,000
	34,630,000	35,776,000

12. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	-	12,777
	-	12,777

ALBSIG JETE SHA

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

13. Kosto të shtyra të marrjes në sigurim

Kostot e shtyra të marrjes në sigurim sipas produkteve më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Sigurimi i jetës:		
sigurimi i jetës së debitorit	55,445,455	31,544,798
sigurimi i jetës në grup	2,117,714	4,587,420
sigurimi sipas skemave 'cash plan'	1,114,149	4,952,480
sigurimi i jetës dhe shëndetit në udhëtim	149	24,655
	58,677,467	41,109,353
	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim në 1 janar	41,109,353	43,163,750
Ndryshimi në shpenzime të shtyra	17,568,114	(2,054,397)
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim në 31 dhjetor	58,677,467	41,109,353

14. Aksione në shoqëri të lidhura

Në datën 4 tetor 2019 Shoqëria ka themeluar shoqërinë aksionare Albsig-Invest Sh.a. Shoqëria është zotëruese e 100% të vlerës së aksioneve në këtë filial. Filiali është një entitet shqiptar që administron dy fonde private të pensioneve dhe një fond të investimeve.

Vlera e investimit më 31 dhjetor 2024 është 69,000,000 Lekë (31 dhjetor 2023: 69.000.000 Lekë).

ALBSIG JETE SHA

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

15. Aktive afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale më datë 31 dhjetor 2024 janë paraqitur si më poshtë:

	Pajisje zyre	Pajisje informatike	Aktive ne proces	Totali
Kosto				
Gjendja më 31 dhjetor 2022	5,264,982	-	-	5,264,982
Shtesa	137,530	55,400	15,582,000	15,774,930
Zhvlerësim i periudhës	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2023	5,402,512	55,400	15,582,000	21,039,912
Shtesa	11,525,449	48,480	65,422,492	76,996,421
Zhvlerësim i periudhës	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2024	16,927,961	103,880	81,004,492	98,036,333
 Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 31 dhjetor 2022	599,551	-	-	599,551
Amortizimi i vitit	892,859	-	-	892,859
Rimarrje e vitit	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2023	1,492,410	-	-	1,492,410
Amortizimi i vitit	1,210,121	-	-	1,210,121
Rimarrje e vitit	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2024	2,702,531			2,702,531
 Vlera neto kontabël				
Gjendja më 31 dhjetor 2022	4,665,431	-	-	4,665,431
Gjendja më 31 dhjetor 2023	3,910,102	55,400	15,582,000	19,547,502
Gjendja më 31 dhjetor 2024	14,225,430	103,880	81,004,492	95,333,802

ALBSIG JETE SHA

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

16. Aktive afatgjata jomateriale

Aktivitet afatgjata jomateriale përfshijnë programe kompjuterike të cilat janë detajuar si më poshtë:

	Programe kompjuterike	Totali
<i>Kosto</i>		
Gjendja më 31 dhjetor 2022	916,759	916,759
Shtesa	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2023	916,759	916,759
Shtesa	1,005,100	1,005,100
Gjendja më 31 dhjetor 2024	1,921,859	1,921,859
<i>Amortizimi i akumuluar</i>		
Gjendja më 31 dhjetor 2022	268,809	268,809
Amortizimi i vitit	147,424	147,424
Gjendja më 31 dhjetor 2023	416,233	416,233
Amortizimi i vitit	267,668	267,668
Gjendja më 31 dhjetor 2024	683,901	683,901
<i>Vlera neto kontabël</i>		
Gjendja më 31 dhjetor 2023	500,526	500,526
Gjendja më 31 dhjetor 2024	1,237,958	1,237,958

17. Rezervat për primet e pafituar

Rezerva për primet e pafituar më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Sigurimi i jetës:		
sigurimi i jetës së debitorit	126,893,194	86,531,893
sigurimi i jetës në grup	18,638,132	16,506,563
sigurimi sipas skemave 'cash plan'	19,354,454	18,496,294
	164,885,780	121,534,750

18. Rezerva teknike për demet

Rezerva teknike për demet më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Sigurimi i jetës:		
sigurimi i jetës së debitorit	85,083,657	42,359,839
sigurimi i jetës në grup	130,000	65,000
sigurimi sipas skemave 'cash plan'	64,168	163,553
	85,277,825	42,588,392

ALBSIG JETE SHA

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

19. Te pagueshme ndaj palëve të lidhura

Te pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Të pagueshme ndaj Albsig sh.a	450,000	209,453
Të pagueshme ndaj Albsig Invest sh.a	-	3,087,786
	450,000	3,297,239

Shoqëria është financuar nga mëma gjate vitit 2021 për qëllime të fillimit të aktivitetit.

20. Detyrime të tjera

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 janë detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Furnitorë	22,125,692	9,274,795
Kreditore të tjerë – Risigurimet	29,100,957	22,178,816
Personeli të tjera	1,575,449	2,536,942
Komision i përlllogaritur	-	3,326
Kreditorë të tjerë	3,365,953	1,335,162
	56,168,052	35,329,041

21. Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2024 është 432,254,000 Lekë i përbërë nga 432,254 aksione të zakonshme me vlerë nominale 1,000 Lek.

Struktura e kapitalit aksionar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 paraqitet si vijon:

	31 dhjetor 2024		
	në %	Numri i aksioneve	Në lekë
Albsig sh.a	100%	432,254	432,254,000
Totali	100%	432,254	432,254,000

	31 dhjetor 2023		
	në %	Numri i aksioneve	Në lekë
Albsig sh.a	100%	432,254	432,254,000
Totali	100%	432,254	432,254,000

Më 31 dhjetor 2024 kapitali i paguar i Shoqërisë është në shumën prej 432,254,000 Lekë (31 dhjetor 2023: 432,254,000 Lekë).

ALBSIG JETE SHA

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

22. Prime të shkruara bruto

Primi i shkruar bruto për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 është detajuar si më poshtë, bazuar në kategorinë e produktit:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Sigurimi i jetës së debitorit	437,138,289	281,687,840
Sigurimi i jetës në grup	36,757,507	27,971,278
Sigurimi sipas skemave 'cash plan'	25,987,216	22,992,515
Sigurimi i jetës dhe shëndetit në udhëtim	247,710	354,982
	500,130,722	333,006,615

23. Prime të çeduar në risigurim

Prime të çeduar në risigurim janë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Risigurime jeta e debitorit	(55,921,730)	(45,059,847)
Totali	(55,921,730)	(45,059,847)

24. Te ardhura nga interesi

Të ardhurat nga interesi janë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Te ardhura nga depozitat	14,628,702	9,994,682
Te ardhura nga fondi investimit	1,533,679	99,639
Te ardhura nga obligacioni OTP Bank	896,714	
Te ardhura nga llogari rrjedhëse	804	10,595
	17,059,899	10,104,916

25. Dëme të paguara të sigurimit

Dëme të paguara të sigurimit janë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Dëme të paguara të sigurimit	36,542,555	17,335,929
Totali	36,542,555	17,335,929

ALBSIG JETE SHA

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

26. Kosto të marrjes në sigurim

Kostot e marrjes në sigurim janë detajuar si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Komisionet e agjentëve	179,258,240	104,032,910
Pagat e rrjetit të shitjes	15,139,318	11,095,637
Shpenzime të tjera të marrjes në sigurim	2,412,432	1,703,694
Totali	196,809,990	116,832,241

Kostot e marrjes në sigurim për çdo linjë produkti janë detajuar si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Sigurimi i jetës së debitorit	191,006,184	102,743,042
Sigurimi i jetës në grup	4,176,486	6,954,742
Sigurimi sipas skemave 'cash plan'	1,495,967	6,945,266
Sigurimi i jetës dhe shëndetit në udhëtim	131,353	189,191
Totali	196,809,990	116,832,241

27. Shpenzimet administrative

Shpenzimet administrative janë detajuar si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Shpenzime personeli	20,346,258	13,313,216
Publicitet, reklama	16,232,636	10,770,000
Qira	1,800,000	1,800,000
Kontributet e sigurimeve shoqërore	4,936,763	3,505,167
Kontribute ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare	6,551,880	4,745,356
Honorare	3,400,000	3,000,000
Shpenzime konsulence	6,622,433	6,275,542
Shpenzime për kancelari	4,802,508	611,755
Amortizim aktive afatgjata	1,477,788	1,040,283
Taksa e tarifa vendore	74,500	74,500
Shpenzime për festa zyrtare	8,280,861	4,136,427
Shpenzime të tjera	4,271,978	4,079,267
	78,797,605	53,351,513

ALBSIG JETE SHA

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

28. Të ardhura financiare neto

Të ardhura financiare neto janë detajuar si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Të ardhura nga diferencat në kursin e këmbimit	2,383,385	4,839,543
Humbje nga diferencat në kursin e këmbimit	(21,530,992)	(16,315,871)
	(19,147,607)	(11,476,328)

29. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin

Më poshtë kemi paraqitur rakordimin e tatim fitimit të llogaritur me normën e aplikueshme të tatimit të fitimit:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Fitimi para tatimit	113,781,963	92,951,511
Total shpenzime të panjohura	820,269	835,734
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	820,269	835,734
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	114,602,233	93,787,245
Tatim fitimi me normën 15%	17,190,335	14,068,087
Fitimi pas tatimit	96,591,628	78,883,424

Tatimi mbi fitimin i pagueshëm në fund të periudhës është si vijon:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Gjendja në fillim	3,303,773	6,435,517
Pagesa gjatë vitit	(18,367,746)	(17,199,831)
Shpenzime të tatim fitimit	17,190,335	14,068,087
Gjendja në fund	2,126,362	3,303,773

Tatimi fitimi në Shqipëri në vitin 2024 llogaritet duke aplikuar normën 15% (2023: 15%) mbi fitimin para tatimit. Shpenzimet e pazbritshme janë të gjitha shpenzimet të pa shoqëruara me dokumentacion, siç kërkohet nga ligji Shqiptar, të gjitha shpenzimet që janë të shoqëruara me dokumente por që nuk janë të njohura nga autoritetet tatimore dhe gjoba të marra për vonesat në dokumentacion drejt Drejtorisë së Tatimeve. Këto shpenzime regjistrohen si të tilla por nuk janë të zbritshme për qëllime tatim fitimi.

30. Veprimet me palët e lidhura

Një numër transaksionesh janë ndërmarrë me palët e lidhura gjatë aktivitetit të zakonshëm të Shoqërisë dhe paraqiten më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Pasqyra individuale e pozicionit financiar		
Të arkëtueshme nga shoqëritë e lidhura	-	12,777
Detyrime ndaj kompanive të lidhura	450,000	3,297,239

Shpërblimi i drejtimit për periudhën deri 31 dhjetor 2024 ka qenë në vlerën 10,901,031 Lekë në muaj (31 dhjetor 2023: 10,199,031 Lekë).

ALBSIG JETE SHA

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

31. Angazhime dhe detyrime të mundshme

Çështje gjyqësore

Në veprimtarinë e zakonshme të biznesit, Shoqëria përfshihet në çështje të ndryshme gjyqësore. Sipas opinionit të drejtimit dhe avokatit ligjor, shoqëria nuk ka dëme që kërkojnë shënime shpjeguese apo njohje të provizioneve në përputhje me SNRF-të. Shoqëria nuk ka angazhime të rëndësishme në datën e raportimit.

32. Ngjarje pas datës së pasqyrave financiare

Përveç sa më sipër, nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit që mund të kërkojë rregullim apo pasqyrim të informacionit në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

ALBSIG JETE SHA

Skedulet plotësuese

(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

Aktive ne mbulim te provigjoneve teknike

Nr.	Emërtimi	% e lejuar	Vlera në fakt
I.	Aktivët e lejuara në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, sipas nenit 97 të Ligjit 52/14		201,095,500
I.5	d) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të tregtuar në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë;	35%	19,630,000
I.9	f) Kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;	40%	15,000,000
I.12	h) Depozita në banka dhe/ose degë të bankave të huaja, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë.	100%	166,465,500
III.	Investime të tjera të lejuara sipas Rregullores nr. 19, date 28.04.2015, neni 4:		266,547,855
III.2	c) Para dhe ekuivalentë të saj (të cilat përfaqësojnë mjete monetare në arkë, mjete monetare në bankë dhe depozita me afat maturimi më të vogël se 3 muaj), në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë, me seli në Republikën e Shqipërisë;	3%	46,763,846
III.5	d) Pjesën e risiguruesit në provigjonet teknike, kur risiguruesit janë të klasifikuar si BBB- e më lart nga Standard & Poor;	100%	78,279,148
III.7	f) Shuma, që detyrohen nga policëmbajtësit dhe ndërmjetësit, e që rrjedhin nga veprimtaria e sigurimeve të drejtpërdrejta dhe risiguroese, n.q.s. nga dita e detyrimit të pagesës nuk kanë kaluar më shumë se 90 ditë, por jo më shumë se 20 % e provigjonit të primit të pafituar;	20%	50,677,124
III.8	g) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara, përveç atyre të parashikuara në shkronjën "gj", pika 1, të nenit 97, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".	5%	14,329,310
III.9	h) Interesa dhe qira të maturuara dhe të ardhura të tjera të maturuara.	5%	17,820,959
III.10	i) Investimet në depozitat e garancisë së Kartonit jeshil pranë BSHS	100%	
III.11	j) Shpenzimet e marrjes në sigurim të shtyra	15%	58,677,467
IV	TOTALI I INVESTIMEVE (I+II+III)		467,643,355
V	TOTALI I INVESTIMEVE TE LEJUARA (Totali i "Vlera në fakt" zbritur "Investime mbi limitet e lejuara")		369,605,940
VI	C. Provigjone teknike, të ndryshme nga ato matematike, bruto (VI.1 deri VI.5)		250,163,605
VI.1	Provigjone të primit të pafituar		164,885,780
VI.2	Provigjone të dëmeve		85,277,825
VII	Tepricë (+) / Mungesë(-) (V-VI)		119,442,335
VIII	Mbulimi në % (V/VI)		147.75%

ALBSIG JETE SHA

Skedulet plotësuese

(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

Kufiri minimal i aftësisë paguese

Albsig jete		31.12.2024
1	1. Kufiri minimal i aftësisë paguese për kontratat që nuk lidhen me fonde të investimeve	
2	<i>Llogaritja e parë</i>	
3	Provigjonet matematike bruto në fund të periudhës	0
4	Provigjonet matematike neto në fund të periudhës	0
5	Raporti i risigurimit ($5=\max(0.85,4/3)$)	0.85
6	Koeficienti i pasigurisë ($6=0.04$)	0.04
7	Rezultati nga llogaritja e parë ($7=3*5*6$)	0
8	<i>Llogaritja e dytë</i>	
9	Vlera e kapitalit në rrezik bruto për kontratat me afat 5 vjet ose më shumë	5,073,503,135
10	Vlera e kapitalit në rrezik neto për kontratat me afat 5 vjet ose më shumë	4,892,764,471
11	Vlera e kapitalit në rrezik bruto për kontratat me afat 3 vjet ose më shumë, por më të vogël se 5 vjet	2,577,509,315
12	Vlera e kapitalit në rrezik neto për kontratat me afat 3 vjet ose më shumë, por më të vogël se 5 vjet	2,573,177,287
13	Vlera e kapitalit në rrezik bruto për kontratat me afat më të vogël se 3 vjet	106,213,057,809
14	Vlera e kapitalit në rrezik neto për kontratat me afat më të vogël se 3 vjet	67,846,502,879
15	raporti i mbajtjes ($15=\max(0.50(10+12+14)/(9+11+13))$)	0.66
16	koeficienti i pasigurisë d1 ($16=0.003$)	0
17	koeficienti i pasigurisë d2 ($17=0.0015$)	0.0015
18	koeficienti i pasigurisë d3 ($18=0.001$)	0.001
19	Rezultati nga llogaritja e dytë ($19=9*15*16+11*15*17+13*15*18$)	82,876,333
20	Kufiri minimal i aftësisë paguese për kontratat që nuk lidhen me fondet e investimeve ($20=7+19$)	82,876,333
21	2. Kufiri minimal i aftësisë paguese për sigurime suplementare	
22	prime të shkruara bruto nga aktiviteti i sigurimeve	500,130,722
23	prime të shkruara bruto nga aktiviteti i risigurimeve	
24	taksa të zbritshme	39,323,731
25	shuma "a" ($25=22+23-24$)	460,806,991
26	Pjesa e shumës "a" më e vogël se 1,000,000,000 Lekë ($26=\min(1,000,000,000, 25)$)	460,806,991
27	Pjesa e shumës "a" më e madhe se 1,000,000,000 lekë ($27=25-26$)	0
28	Koeficienti i pasigurisë b1 ($28=0.18$)	0.18
29	Koeficienti i pasigurisë b2 ($29=0.16$)	0.16
30	dëme të paguara bruto	36,542,555
31	pjesa e risiguruesit në dëmet e paguara	1,445,096
32	Dëme të paguara neto ($32=30-31$)	35,097,459
33	provigjone bruto të dëmeve në periudhën aktuale	80,277,825

ALBSIG JETE SHA

Skedulet plotësuese

(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

34	provigjone bruto të dëmeve në fund të vitit të kaluar	42,588,392
35	pjesa e risiguruesve në provigjonet e dëmeve në periudhën aktuale	33,611,860
36	pjesa e risiguruesve në provigjonet e dëmeve në fund të vitit të kaluar	5,821,312
37	provigjone neto të dëmeve në periudhën aktuale (37=33-35)	46,665,965
38	provigjone neto të dëmeve në fund të vitit të kaluar (38=34-36)	36,767,081
39	ndryshimi në provigjonet e dëmeve bruto (39=33-34)	37,689,433
40	ndryshimi në provigjonet neto të dëmeve (40=37-38)	9,898,884
41	dëme të ndodhura bruto (41=30+39)	74,231,988
42	dëme të ndodhura neto (42=32+40)	44,996,343
		0.61
43	raporti i mbajtjes (43=max(0.50,42/41))	0.61
44	Kufiri minimal i aftësisë paguese për sigurimet suplementare (44=(28*26+29*27)*43)	50,277,966
45	3. Kufiri i aftësisë paguese për kontrata të lidhura me fonde të investimeve	
46	<i>Llogaritja e parë</i>	
47	Provigjonet matematike bruto ku rreziku i investimeve është marrë nga siguruesi	0
48	Provigjonet matematike bruto ku rreziku i investimeve nuk është marrë nga siguruesi, kur periudha e transaksioneve i kalon 5 vjet për të cilat kostot e manaxhimit është caktuar për më shumë se 5 vjet	0
49	Provigjonet matematike neto ku rreziku i investimeve është marrë nga siguruesi	0
50	Provigjonet matematike neto ku rreziku i investimeve nuk është marrë nga siguruesi, kur periudha e transaksioneve i kalon 5 vjet për të cilat kostot e manaxhimit është caktuar për më shumë se 5 vjet	0
		0
51	<i>raporti i mbajtjes (51=max(0.85,(49+50)/(47+48))</i>	0.85
52	koeficienti i pasigurisë d1 (52=0.04)	0.04
53	koeficienti i pasigurisë d2 (53=0.01)	0.01
54	Rezultati i llogaritjes së parë (54=47*51+48*51*53)	0
55	<i>Llogaritja e dytë</i>	
56	Vlera e kapitalit në rrezik bruto	0
57	Vlera e kapitalit në rrezik neto	0
		0.50
58	<i>raporti i mbajtjes(58=max(0.5,57/56))</i>	0.50
59	<i>koeficienti i pasigurisë (59=0.003)</i>	0.003
60	Rezultati i llogaritjes së dytë(60=56*58*59)	0
61	Kufiri i aftësisë paguese për kontrata të lidhura me fonde të investimeve (61=54+60)	0
62	Kufiri minimal i aftësisë paguese (62=20+44+61)	133,154,299

ALBSIG JETE SHA

Skedulet plotësuese

(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

Mjaftueshmëria e kapitalit

	31 dhjetor 2024
A: Kapitali bazë dhe kapitali shtesë (kapitalet e veta sipas pasivit te bilancit)	711,682,462
B: Elementet e zbritshëm ne llogaritjen e kapitalit shtese sipas nenit 79 të ligjit 52/2014	182,947,126
<i>Investime në pjesëmarrje</i>	69,000,000
<i>Debitorë të tjerë ose llogari të tjera të arkëtueshme, të cilat nuk rrjedhin drejtpërsëdrejti nga veprimtaria e sigurimit;</i>	450,000
<i>Primet e arkëtueshme ose debitorë nga risigurimi që kanë tejkaluar afatin 90- ditor</i>	31,821,770
<i>Toka, ndërtesa dhe të drejta në pasuri të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë</i>	81,004,489
<i>Inventari</i>	670,867
Kapitali aftësia paguese (A-B)	-
Kufiri minimal i aftësisë paguese, sipas pikës 3 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014	528,735,336
Fondi i garancisë, sipas nenit 81 të Ligjit Nr. 52/2014	133,154,299
Niveli i kërkuar i aftësisë paguese, sipas pikës 2 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014	370,000,000
Mbi (+) / nën (-) nivelin e kërkuar të aftësisë paguese	370,000,000
	158,735,336
Mjaftueshmëria e kapitalit	I mjaftueshëm
Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit	142.90%